



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 17 NËNTOR 2015**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 17. NOVEMBRA 2015. GODINE**

**NËNTOR - NOVEMBAR
2015**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016

Dnevni red

1. Prvo razmatranje Nacrt zakona o budžetu Republike Kosova za 2016. godinu

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Ministra të Kabinetit qeveritar,

Ju kisha lutur, të mos krijojmë skena, ndërsa e lus opozitën të mos ndezë diçka, as të mos të reagojë. A ka mundësi një minutë pauzë! Vetëm pak! Jam duke bashkëbiseduar. Vetëm pak qetë! Ju kisha lutur të mos krijojmë skena. Pritni veç pak! Vetëm më dëgjoni çfarë po propozoj, pastaj është çështja juaj si veproni.

Dëgjoni, a ka mundësi që të ulemi në vend, ndërsa vetëm shefat e grupeve parlamentare të tregojnë nëse duam ta vazhdojmë seancën, apo jo.

(Reagime nga salla)

Hiç! Dëgjo, më fal! Ramush, po të drejtohem si kryetar: A ka mundësi vetëm të deklarohen “po” ose “jo”. Vetë e merrni përgjegjësinë të bllokimit dhe të përjashtimit nga seanca në qoftë se nuk i lejoni deputetët tjerë ta mbajmë seancën. Vetëm kaq! Pastaj do të shkojmë në pauzë. As s’keni nevojë ta vetinkrimoni veten, as s’keni nevojë të krijoni gaz lotsjellës, as s’keni nevojë të përlesheni me Policinë.

(Reagime nga salla)

Dëgjo, është vendim i Kryesisë. Ju kisha lutur, a ka mundësi që vetëm të deklaroheni “po” ose “jo”. Kërkoj nga shefat e grupeve parlamentare, vetëm deklarim njerëzor po ju kërkoj. Merreni përgjegjësinë institucionale. Është vendim i Kryesisë së Kuvendit, prandaj ju kisha lutur vetëm ta bëni deklarin, njëjtë siç po e bëni këtu, le të ju dëgjojnë edhe mediat, edhe deputetët. Unë thashë, vetëm bëjeni deklarin secili shef i grupit parlamentar, ose përfaqësuesit e grupit parlamentar, pastaj do të kalojmë në pauzë dhe do ta kërkojmë mbledhjen e Kryesisë.

Vetëm edhe një herë po e ripërsëris, jeni duke e vetëpërjashtuar vetveten nga punimet e seancës plenare me moslejimin e mbajtjes së seancave. Ka mundësi të deklarohen vetëm shefi i Grupit Parlamentar i PDK-së, shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, “Vetëvendosjes”, AAK-së, të gjitha me radhë. Me kaq shkojmë në pauzë.

Visar, të kisha lutur, je kryetar i partisë, dëgjo - vetëm deklarohuni. Unë nuk po kërkoj asgjë, nuk po insistoj asgjë. Vetëm deklarohuni!

Adem Grabovci, nga shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, deklarohu! A doni të mbajmë seancë, apo jo?

(Reagime nga salla)

Nuk duhet të ketë seancë, ju dëshironi ta bllokoni seancën?!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike u është drejtuar edhe me shkrim, edhe sot deklaroj se ne duhet ta vazhdojmë seancën.

KRYETARI: Ismet Beqiri!

Pauzë! Mbledhja e Kryesisë! Pauzë! Qetësi, ju lutem! Pauzë! Të gjithë deputetët, mbledhja e Kryesisë në zyrën time. Pauzë!

(Në sallë hidhet gaz lotsjellës nga partitë opozitare.)

* * *

*Vazhdimi i mbledhjes plenare në sallën alternative
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

KRYETARI: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar ambasadorë, faleminderit për praninë tuaj,
Përfaqësues i OSBE-së,
Të nderuara media,

Së pari, në rend të parë dua ta theksoj këtë gjendje, në të cilën erdhëm deri këtu. Ka qenë një vendim i imponuar nga Kryesia e Kuvendit dhe imi si kryetar i Kuvendit për arsye se vazhdimi i seancës në ambientin e sallës poshtë ka qenë pothuajse i pamundur për shkak të materies toksike, e cila është hedhur në mënyrën më të papërgjegjshme nga individë të caktuar deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Shpresojmë se së pari nuk do të duhej të ndodhte kjo, shpresojmë se shumë shpejt do ta vazhdojmë punën normale aty ku edhe e kanë vendin deputetët dhe ky është një insistim yni i përbashkët si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Unë do t'i hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ju njoftoj se kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa, në bazë të nenit 69.4 të Kushtetutës dhe të nenit 38.2 të Rregullores së Kuvendit, ka kërkuar mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për shqyrtimin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2015, ka vendosur që Kuvendit t'ia propozojë shqyrtimin e parë të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Deputetë të nderuar,

Para se të futemi në punën rreth buxhetit, kryeministri i Republikës së Kosovës e ka kërkuar fjalën. E lus secilin që e merr fjalën, qoftë nga Qeveria, qoftë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, të drejtohet nga foltorja. Është edhe për çështjen e përkthimit. Urdhëroni i nderuar kryeministër, pastaj edhe zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi, e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
E nderuar Kryesi,
Të nderuar deputetë,
Zëvendëskryeministra, ministra,
I nderuar ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës,
Përfaqësues të Bashkimit Evropian,
Përfaqësues të tjerë diplomatikë, ju përshëndes të gjithëve,

Unë shpreh papajtueshmërinë time të plotë dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës, mendoj edhe të qytetarëve të Republikës së Kosovës me sjelljen e opozitës në seancën e sotme të Kuvendit, por edhe në seancat e mëparshme.

Kjo që ndodhi sot mendoj që është akt kriminal i individëve, për të cilin institucionet e Republikës së Kosovës duhet të marrin masa. Është i papranueshëm një tolerim i tillë i sjelljes në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ata që sulmojnë, ata që hedhin gaz lotsjellës, ata që hedhin masa kimike, me të cilat e cenojnë shëndetin edhe jetën e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, edhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfaqësuesve diplomatikë në Kuvend, ata duhet të përgjigjen para ligjit.

Dhe unë kërkoj nga institucionet e ligjit që ata të marrin masa, sepse kjo situatë është e patolerueshme. Ne nuk do të lejojmë, as s'duhet të lejojnë që deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, shumica parlamentare prej gati 90 deputetëve, të mbajë seancë këtu, ndërkaq të pengojnë 30 deputetë, ose 3-4 individë, me mjete të dhunshme, që seanca e Kuvendit të mos mbahet aty ku duhet të mbahet. Ne kemi institucione, ju keni dalë nga vota e lirë të qytetarëve dhe jeni pronarë të votës suaj. E keni të drejtën legjitime që t'i përfaqësoni qytetarët e Republikës së Kosovës me votën që e keni marrë dhe askush nuk ka të drejtë ta cenojë të drejtën e 90 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës që ata në mënyrë të lirë dhe të pavarur ta ushtrojnë funksionin edhe pozitën e tyre.

Kjo është përgjegjësi e institucioneve të drejtësisë, përgjegjësi e institucioneve shtetërore dhe ato duhet ta bëjnë punën e vet. Këto institucione nuk janë për të bërë politikë, sepse nuk është më politikë sjellja e dhunshme e individëve në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kjo e kapërcen politikën, i kapërcen rivalitetet politike, i kapërcen veprimet politike. Këto janë veprime të dhunshme dhe ata që bëjnë veprime të dhunshme në Kuvend duhet të përgjigjen sikur që duhet të përgjigjen edhe ata që bëjnë veprime të dhunshme në qytet ose në gjetiu dhe nuk u përmbahen ligjeve të Republikës së Kosovës.

Unë shpreh gatishmërinë e plotë Qeverisë së Republikës së Kosovës që ta zbatojë ligjin dhe do të kërkoj nga të gjitha institucionet e Qeverisë që ta bëjnë këtë. Mirëpo kërkoj edhe prej institucioneve tjera të Republikës së Kosovës që ato më të mos sillen në mënyrë të verbër dhe të shurdhët para kësaj çfarë po ndodh, por të marrin masa ligjore, sepse është në pyetje shteti. Në qoftë se sulmohet organi më i lartë legjislativ i Kosovës, atëherë sulmohet esenca e shtetit të Kosovës dhe ata që e sulmojnë këtë duhet të përgjigjen para ligjit dhe ata nuk mund të sillen në formë të tillë edhe më tutje për arsye se ky Kuvend duhet të punojë.

Dhe, unë ju garantoj që ne do të bëjmë çdo gjë që Kuvendi ta vazhdojë punën e vet, që ju ta bëni punën atje ku ju takon edhe që ju ta merrni dhe ta realizoni përgjegjësinë që jua kanë dhënë qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar kryeministër! Fjalën e ka zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar Veseli,
I nderuar kryeministër Mustafa,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar ambasadorë,
Të gjithë ju përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë,
Dëshiroj që t'i drejtohem edhe opinionit publik me mesazhin që përsëri sot ,ne mbi 80 deputetë,
2/3 e Kuvendit të republikës së Kosovës, u ballafaquam mund të themi lirisht me sulm, jo vetëm
veprime opozitare, kundër koalicionit qeverisës, por veprime direkt fizike, kriminale të
çmendura, veprime çmenduruese për ta penguar punën dhe funksionimin e Parlamentit të
Kosovës.

Ne jemi të zgjedhurit e qytetarëve të Kosovës, sikur që janë edhe ata që po ndërmarrin veprime
kriminale në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ne jemi të zgjedhurit për ta implementuar agjendën tonë shtetërore, siç është edhe sot Buxheti i
Republikës së Kosovës për vitin e ardhshëm. Një buxhet ky zhvillimor, një buxhet për
mirëqenien sociale të qytetarëve, një buxhet ky i mundësive tona, por edhe një buxhet që do të
hapë mundësi për reformat euroatlantike për Kosovën.

Ne një kohë ballafaqohemi me këto shfaqje në Kuvendin e Kosovës, natyrisht se duke dashur që
t'i kontribuojmë qetësisë, mirëkuptimit, tolerancës, ndoshta edhe e kemi kaluar vijën e kuqe të
tolerancës ndaj veprimeve aspak politike, por të dhunshme dhe definitivisht kriminale.

Sot, sulmi nuk ishte vetëm gaz lotsjellës, por ishte helm drejtuar deputetëve dhe Kabinetit
qeveritar.

Prandaj, duke mos pasur argumente për ballafaqimin në Kuvendin e Kosovës, për debat në
Kuvendin e Kosovës, këta liderë opozitarë na kanë sjellë në një situatë të gjithë neve, por edhe
qytetarët e Kosovës, edhe bashkësinë ndërkombëtare aspak të lakmueshme.

Vlerësoj se duke e respektuar Kushtetutën e Kosovës, ligjet e Kosovës, duke e respektuar mbi të
gjitha një proces, që ka qenë elektoral fer, i lirë, transparent, i pranueshëm prej gjithë spektrit
politik, edhe prej atyre që po veprojnë dhunshëm dhe në mënyrë kriminale, zgjedhje këto të
pranuara dhe të njohura edhe ndërkombëtarisht, të vlerësuara shumë lart si zgjedhjet më të mira
të pasluftës, zgjedhjet e qershorit të vitit 2014, mendoj se në asnjë moment nuk duhet të ketë
hezitime sa i përket se si do të vazhdojmë më tutje.

Ne do të vazhdojmë. Askush nuk do të mund ta bllokojë Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe
toleranca ndaj këtyre veprimeve të dhunshme dhe kriminale duhet të jetë zero. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar zëvendëskryeministër! E dëshiron dikush tjetër fjalën?
Urdhëroni, zonja Melihate Tërmkolli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra,

Të nderuar pjesëmarrës, zoti ambasador i SHBA-ve,

Përfaqësues i OSBE-së,

Të nderuar deputetë,

Gati nuk kam shumë çka të them thanë pas fjalës së kryeministrit dhe të zëvendëskryeministri, por sinjerisht është një diçka që ndoshta, ne që kemi qenë pjesë e disa angazhimeve dhe veprimtarive të mëhershme, e kemi një ndjenjë tepër të rëndë me këtë çka po ndodh sot në Kosovë.

Në fakt, Kosova ka mbajtur këso takimesh vetëm kur ka qenë e pushtuar, vetëm kur kemi qenë të okupuar nën regjimin serb dhe definitivisht në Kosovën shtet i lirë i pavarur e demokratik, këto veprime janë totalisht të papranueshme, janë të dënueshme dhe janë veprime të cilat shteti i Kosovës më nuk mund t'i lejojë.

Unë nuk e di se si do të zgjidhet kjo çështje, por e di që kështu definitivisht më nuk guxon të ndodhë. Unë nuk mund të marrë pjesë, sikur besoj edhe ju shumë të tjerë këtu, në kesi 'buxhaki' në Parlamentin e Kosovës, në një shtet të pavarur, në një shtet demokratik. Askush nuk ka të drejtë ta vë sot në Parlamentin e Kosovës në këtë pozitë dhe askujt nuk i lejohet, sepse kemi dhënë shumë, kemi sakrifikuar shumë, krejt qytetarët e Kosovës, krejt populli i Kosovës, krejt miqtë tanë ndërkombëtarë për ta bërë një shtet si duhet.

Prandaj, ju lutem të gjithë juve, edhe Qeveria, edhe Parlamenti, edhe kryetari i Parlamentit, edhe të gjitha institucionet, të punojmë që të funksionojnë institucionet e shtetit të Kosovës, pavarësisht i pëlqen dikujt, apo nuk i pëlqen. Në demokraci gjithkush ka të drejtë ta shprehë mendimin e vet, por jo ta pengojë shtetin, jo t'i pengojë institucionet që janë bazamenti i funksionimit të shtetit të Kosovës, siç është Parlamenti i Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, e nderuar Tërmkolli! Deputetë të nderuar, po e shoh se s'e ka kërkuar askush fjalën, do të vazhdojmë.

Para se të fillojmë me shqyrtimin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, Kuvendi duhet të deklarohet për propozimin e Komisionit Funksional për Buxhet dhe Financa që shqyrtimi i këtij projektligji të bëhet me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funksional për Buxhet dhe Financa, deputetin Naser Osmani, që ta paraqesë propozimin.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar, kryeministër, zëvendëskryeministra, deputetë,

Më 4 nëntor të këtij viti, Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka mbajtur mbledhjen konform nenit 40 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, e ka shqyrtuar buxhetin dhe ka ardhur në përfundim që të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit shmangien nga Rregullorja në kuptimin e asaj që ne ta bëjmë në procedura të përshpejtuara Ligjin e buxhetit, që mund të arrijmë miratimin në leximin e dytë në javën e parë të dhjetorit, ashtu siç është bërë konform një marrëveshjeje me Fondin Monetarë Ndërkombëtar.

Prandaj, në emër të Komisionit, ju ftoj që ta votoni shmangien që t'i qasemi leximit të parë të Projektbuxhetit për vitin 2016. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Osmani! Kërkohej deklarimi i grupeve parlamentare. Adem Grabovci, nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i jep përkrahje kësaj shmangie, sepse kemi parasysh se kemi të bëjmë me dokumentin më të rëndësishëm të shtetit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zotëri Grabovci! Ismet Beqiri, nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Gjithashtu, edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah propozimin e tillë për shmangie nga Rregullorja dhe do të votojë për. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” nuk është këtu. Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk është këtu. Grupi Parlamentar Lista serbe, urdhëro Slavko!

SLAVKO SIMIČ: Hvala, predsedniče! I poslanička grupa Srpska lista podržaci ostupanja od Poslovnika i glasaćemo za! Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Nisma” nuk është këtu. Grupi Parlamentar “6+”, urdhëro zoti Damka!

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar! Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah propozimin e komisionit për shmangien e Rregullores për Buxhetin e Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro i nderuar profesor Muhamet Mustafa e ka kërkuar fjalën, para se të procedojmë.

MUHAMET MUSTAFA: Ju përshëndes të gjithëve,

Vetëm shkurt desha të them që unë e mbështes plotësisht këtë shmangie nga Rregullorja, por kisha kërkuar që ta bëjmë një kalendar të përditshëm që amendamentet në buxhet të mos vonohen, por të bëhen sa më shpejt brenda 3-4 dite, në mënyrë që ky komision dhe komisionet tjera të kenë kohë që ta kryejnë punën në mënyrë të përgjegjshme dhe cilësore.

Ne jemi duke punuar në kushte jo normale, por kemi përgjegjësi që punën ta bëjmë në mënyrën më cilësore dhe me përgjegjësinë më të lartë për qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti profesor Mustafa! Unë po bëj një sqarim procedural: Në bazë të nenit 84 të Rregullores së Kuvendit përcaktohet se për t'iu shmangur Rregullores së Kuvendit vendoset me 2/3 e deputetëve të pranishëm, po e ripërsëris - të pranishëm në mbledhjet plenare.

Shmangia mund të bëhet kur nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me standardet evropiane.

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Lus deputetët, para se të votojmë, ta marrim numrin e saktë të deputetëve. Në sallë janë 80 deputetë të pranishëm aktualisht në sallën e Kuvendit. Do të votojmë me dorë: Kush është për, me ngritje dore?

Faleminderit! Në fakt, numrin që e kam marrë të deputetët që kanë votuar për është ai i të pranishmëve. 80 janë për.

Do të thotë, Kuvendi e miratoi propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit lidhur me afatet kohore për shqyrtimin e parë dhe të dytë të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

(Ndërhyrje)

Vetëm pak! Atëherë ju kisha lutur 80 vota, edhe një herë do të shkojmë në votim.

Ata që duhet të kërkojnë falje janë ata që ma kanë sjellë këtë, e unë e tërheq. Administrata ma ka sjellë kështu edhe për shqyrtimin e dytë të projektligjit. Vetëm edhe njëherë te votimi të jemi në rregull, pasi jemi para publikut.

Do të votojmë edhe një herë kush është për, për arsye se 80 janë të pranishëm dhe 80 për, me abstenim nuk shkon. Atëherë, duhet verifikim i pranisë së deputetëve edhe një herë, ju kisha lutur. Të keni mirëkuptim edhe për punonjësit e Administratës për arsye të rrethanave në të cilat jemi, e nuk e kanë shumë të lehtë. I ndihmoni, ju lutem!

Unë do ta lexoj rekomandimin pse Administrata e ka sjellë kështu. Ju kisha kërkuar vëmendjen. Në pikën 3 të rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa është kështu: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 bëhet në seancën plenare të radhës, që është kjo, dhe shqyrtimi i dytë të bëhet më së voni deri më 9 dhjetor. Kjo parashihet kur e lexova më herët.

Atëherë do të mbetet edhe shqyrtimi i dytë, por më së voni deri më 9 dhjetor. Ne mund pas një jave kurdo, kur që komisioni të përgatitet. Ta kemi këtë parasysh. Faleminderit!

Të pranishëm në sallë janë 80. Kush është kundër? Nait Hasani është kundër. A ka ndonjë tjetër kundër? Kush është për abstenim? Asnjë! 79 vota janë për, 1 është kundër, 0 abstenim.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit lidhur me afatet kohore për shqyrtimin e parë dhe të dytë të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Abdullah Hoti, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 adreson objektivat zhvillimore të Qeverisë së Republikës së Kosovës të prezantuar në Programin qeverisës, të cilin e kemi diskutuar bashkë.

Hartimi i projektligjit ka marrë parasysh ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale, të cilën e kemi ndërtuar gjatë këtij viti dhe financimin e prioritetëve të Qeverisë brenda kufizimeve që kemi pasur. Projektligji që po e diskutojmë sot është harmonizuar plotësisht me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe ka marrë parasysh të gjitha çështjet, të cilat ne i kemi diskutuar me të.

Më lejoni shkurtimisht tani të flas për kontekstin makroekonomik brenda të cilit është përgatitur ky buxhet. Ne presim që në vitin 2016 rritja ekonomike të jetë 3,8%, që është rritja më e lartë në rajon dhe më gjerë, ndërsa për tre vjetët e ardhshme mesatarisht e kemi një rritje ekonomike prej 4,2%, por duke mos marrë parasysh efektin e projekteve të mëdha zhvillimore, të cilat pritet të implementohen, besoj do të fillojmë në fund të këtij viti dhe vitin e ardhshëm, siç është projekti në energjetikë, në Brezovicë, dhe projekte të tjera.

Ne presim që investimet të rriten mesatarisht me nga 10% dhe të shkojnë rreth 27% e bruto-prodhimit vendor, së bashku me investimet private dhe ato publike. Ne presim që eksportet të rriten me rreth 7%, duke e zvogëluar deficitin tregtar me kalimin e viteve. Ne presim që konsumi të rritet me vetëm 3,5%, pasi do të fillojë të mbulohet me prodhimin vendor.

Të hyrat për vitin 2016 i kemi planifikuar në nivel prej 1 miliard e 598 milionë euro, që është një rritje prej 4,1% krahasuar me këtë vit dhe është një rritje prej 19% krahasuar me vitin 2014. Të hyrat vendore presim që do të rriten me 8,8%, ndërsa ato nga Dogana me 6,2%.

Kjo rritje e të hyrave merr parasysh efektet e politikës fiskale që ka në Buxhetin e Kosovës nga lirimi i TVSH-së të importit të makinerive prodhuese dhe lëndëve të para, dhe efektin që ka Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me të hyrat buxhetore.

Shpenzimet buxhetore për vitin 2016 do të jenë 1 miliard e 680 milionë euro, që është një rritje prej 2% në raport me këtë vit dhe 14% mbi shpenzimet e realizuara të vitit 2014. Ne i kemi racionalizuar shpenzimet dhe me këtë racionalizim dhe me rritje të të hyrave shtesë është bërë e mundur që këtë buxhet të përfshijmë një rritje prej 25% për asistencë sociale për 17 mijë familje që janë në këtë skemë për zbatimin e plotë të Ligjit për skemat e financuara nga shteti me një

buxhet shtesë prej 23 milionë krahasuar me buxhetin e këtij viti për t'i kategorizuar këta pensionistë dhe për t'i futur në zbatim dy skema të reja pensionale - ato të pensionit familjar dhe të pensionit invalidor, është ndarë buxhet i mjaftueshëm për ta paguar përvojën e punës, që kushton rreth 30 milionë euro për 80 mijë të punësuar në sektorin publik. Do të vazhdojë mbështetja për bujqësinë, siç ka qenë edhe këtë vit, dhe janë siguruar rreth 25 milionë euro shtesë për pensionet e veteranëve dhe të kategorive tjera të dala nga lufta.

I kemi akomoduar obligimet që kemi si shtet i Kosovës ndaj marrëveshjeve ndërkombëtare, që janë rreth 6 milionë. E kemi rritur buxhetin për organet e drejtësisë prej 13% për prokurori dhe për gjyqësi me 6%. E kemi rritur buxhetin për 9% për Forcat e Sigurisë të Kosovës, për modernizimin dhe përmbushjen e standardeve.

Buxheti për shpenzime kapitale do të jetë 463 milionë euro dhe mundëson financimin e 39 shkollave dhe anekseve shkollore në mbarë vendin, ndërtimin e objekteve për universitetet e reja në Mitrovicë, Gjilan, Gjakovë dhe në Pejë. 25 objekte sportive, 4 qendra rinore, 24 objekte të ndryshme në fushën e shëndetësisë primare, sekondare dhe terciare, janë 15 objekte të kulturës dhe të artit, mbi 116 rrugë të ndryshme regjionale dhe lokale në tërë Kosovën, është financimi i plotë i autostradës Prishtinë - Hani i Elezit dhe projekteve që janë në vijim e sipër në mënyrë të papenguar, janë mbi 30 projekte në ujëra dhe në mbrojtje të mjedisit dhe gjithashtu investimet kapitale për Forcën e Sigurisë të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Si pjesë e reformës së menaxhimit të financave publike ne kemi bërë klasifikimin e shpenzimeve buxhetore sipas kategorive dhe më lejoni të ju informoj që rreth 22% e shpenzimeve buxhetore shkojnë për fushën e ekonomisë, pra për zhvillim ekonomik, në infrastrukturë dhe në fushat e tjera. Janë 22% tjera që shkojnë për aspektin social, për mbrojtjen sociale për shkak të agjendës së fortë sociale që ka shteti i Kosovës, 17% shkojnë në fushën e arsimit, 11% shëndetësi, në rend dhe siguri 9%, në mbrojtje 3%, në mjedis 1%, në çështjet e banimit dhe komuniteteve 3%, në rekreacion, kulturë dhe religjion 2%.

Si përqindje e bruto-produktit vendor, buxheti i shtetit është rreth 28%, gjë që është e pranueshme për një ekonomi të tregut, siç është Kosova. Më lejoni të theksoj para jush që ky buxhet është harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe i adreson të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që i kemi pranuar nga ata sa i përket ruajtjes së qëndrueshmërisë fiskale, të ndërtuar gjatë këtij viti.

Më lejoni shkurtimisht të paraqes para jush edhe propozimin e Qeverisë për financimin e Radiotelevizionit të Kosovës, një temë që është mjaft e ndjeshme për të gjithë ne për mediumin e vetëm publik në Kosovë. Ne jemi të vendosur që të sigurojmë financimin e qëndrueshëm dhe të papenguar të këtij televizioni. Gjatë dy leximeve do vijmë me propozim në Komisionin për Buxhet dhe Financa, dhe në komisionin përkatës për media me një zgjedhje afatshkurtër të financimit të RTK-së dhe jemi të gatshëm ta mbështetim Kuvendin dhe komisionin parlamentar për zgjidhjen afatgjatë sa i përket Radiotelevizionit të Kosovës, gjithmonë duke kërkuar edhe informata të plota për mënyrën sesi po shpenzohen këto para publike, sepse në fund të fundit janë taksat të qytetarëve. Faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar ministër! Tani fjalën e ka kërkuar kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë do të përpiqem që sot në mënyrë të shkurtër vetëm t'i prezantoj disa prej orientimeve themelore të Qeverisë dhe të kërkoj nga ju që ta përkrahni Projektligjin për Buxhetin në leximin e parë, ndërkaq ju siguroj që gjatë dy leximeve do t'i marrim parasysh të gjitha propozimet, vërejtjet e grupeve parlamentare, të komisioneve, në mënyrë që të bëjmë përpjekje maksimale që brenda mundësive të gjitha ato t'i akomodojmë në suaza të buxhetit të cilin e kemi.

Ekziston po ashtu mundësia që në bazë të marrëveshjes të cilën e kemi me Fondin Monetar Ndërkombëtar, për të cilën foli ministri, që ne të bëjmë ndërhyrje dhe me investime kapitale në të gjitha ato fusha ku sigurojmë se ato investime do ta rritin ekonominë dhe do të sigurojnë punësim të ri. Është fjala për mundësinë tonë që të hyjmë në hua të jashtme dhe ta kalojmë kufizimin që e kemi pasur deri më tani të 2% në bruto-produktin vendor brenda një viti, prandaj me këtë edhe do ta ndryshojmë edhe rregullën fiskale me aprovimin e Ligjit të ri për financat publike, i cila tani është në procedurë dhe me këtë ne parashohim që buxheti për vitin e ardhshëm do të jetë diku afro 2 miliardë euro me pjesën të cilën do ta kemi si të hyrë jo fiskale nëpërmjet huave që ne mund t'i marrim për ndërtime të ndryshme infrastrukturore dhe për përkrahje të ekonomisë, të cilat sigurojnë gjenerim vendeve të punës.

Natyrisht se Projektligji për Buxhetin është një prej vendimeve më të rëndësishme që marrin qeveritë dhe Parlamenti, dhe mendoj se ky është një vendim prej të cilit ne në mënyrë të drejtpërdrejtë e përcaktojmë perspektivën tonë zhvillimore për vitin 2016. Ne si Qeveri e kemi përcaktuar zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të reja të punës, luftën kundër evazionit fiskal, kontrabandës, krimit të organizuar, korrupsionit dhe integrimin tonë euroatlantik, kultivimin e partneritetit me miqtë tanë ndërkombëtarë si prioritetet tona dhe unë ju siguroj që këto prioritetet do t'i mbështetim edhe me këtë buxhet, por do t'i mbështetim po ashtu edhe me sjelljet tona në ekzekutimin e buxhetit, në mënyrë që ekzekutimi i buxhetit të jetë sa më racional, shpenzimet të jenë sa më rationale dhe shpenzimet kryesisht të jenë ato që i kontribuojnë ndërtimit të institucioneve të shtetit dhe që i kontribuojnë rritjen sonë ekonomike.

Ne presim që brenda këtij viti, në bazë të dhënave që i kemi nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, nga Banka jonë Qendrore, nga bankat ndërkombëtare dhe institucionet e tjera financiare, por edhe nga Agjencia e Statistikave ta kemi një rritje mesatare ekonomike prej rreth 3%. Ndoshta kjo rritje do të jetë edhe më e madhe se kjo dhe mendojmë se kjo rritje pastaj na mundëson që në vitin 2016 ta shtojmë rritjen tonë ekonomike, sidomos në fushat në të cilat ne u kemi dhënë prioritet dhe kjo është në rend të parë fusha e bujqësisë, e cila siguron punësim më intensiv, sepse çdo vend i punës na kushton më lirë dhe unë mendoj se kemi investuar mjaft shumë edhe këtë vit edhe kemi potencial të investojmë edhe vitin e ardhshëm.

Është energjetika, për të cilën ne tani po zhvillojmë biseda me një konsorcium të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe jemi afër marrëveshjes për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re", me të cilën ne do të sigurojmë energji elektrike për ekonominë dhe për qytetarët. Pastaj është një projekt shumë i rëndësishëm i Brezovicës si investim i jashtëm dhe po ashtu po

punojmë mjaft shumë që të tërheqim investitorë të jashtëm edhe në fushat e tjera, sidomos të zhvillimet minerare dhe të shfrytëzimit të minierave si resurse shumë të rëndësishme të vendit tonë.

Tash ne e kemi nënshkruar Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim. Ajo marrëveshje është ratifikuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe konsideroj se është një prej marrëveshjeve tepër të rëndësishme, e cila hap mundësinë e zhvillimit tonë. Tash unë po flas për zhvillimin në kontekstin e asaj se pa një zhvillim ekonomik ne nuk mund ta zgjerojmë bazën tatimore dhe bazën fiskale në mënyrë që të grumbullojmë më shumë dhe ta shtojmë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Ne nuk dëshirojmë që buxheti të shtohet nëpërmjet rritjes së normave të tatimeve dhe taksave, ose normave të kontributeve të ndryshme, mirëpo ky buxhet të shtohet duke e ulur evazionin fiskal dhe duke e zgjeruar bazën tatimore, duke e përfshirë një numër më të madh të taksapaguesve dhe po ashtu duke e bërë rritjen ekonomike nëpërmjet së cilës do të mundësojmë që ne ta krijojmë një konvergjencë të domosdoshme ndërmjet politikave fiskale dhe politikave zhvillimore, për çfarë unë mendoj se i kemi bërë të gjitha përgatitjet e domosdoshme me pakon e ligjeve, të cilat ne i kemi aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me ato që i kemi në procedurë tani dhe me ato që do t'i iniciojmë edhe vitin e ardhshëm.

Ne presim që nga instrumenti për anëtarësim IPA do ta kemi diku një përkrahje rreth 600 milionë euro deri në vitin 2020, të cilën do ta adresojmë për vitet e caktuara deri atëherë dhe e cila është një mbështetje shumë e rëndësishme edhe zhvillimore, por edhe një mbështetje buxhetore për vendin tonë. Unë nuk do ta zgjas më shumë, por kërkoj nga ju që sot ta aprovojme këtë buxhet në leximin e parë, ndërkaq në dy leximet do t'ju ofrojmë bashkëpunim të plotë që ne t'i harmonizojmë dhe të përpiqemi maksimalisht që t'i inkorporojmë të gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar kryeministër!

Të nderuar deputetë,

Pas prezantimit të projektligjit, e hap debatin për diskutim në parim. Radhitja e diskutuesve do të jetë nga kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa. E ftoj zotin Naser Osmanin.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

I nderuar ministër i Financave,

Të nderuar deputetë,

Përgatitja e Projektligjit vjetor të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016 është pasqyrim i kërkesave ligjore të parapara në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Projektbuxheti përmban Kornizën makro-fiskale për vitin 2016, që pasqyron të dhënat për rrjedhat makroekonomike aktuale, për treguesit makroekonomikë dhe trendin e të hyrave dhe shpenzimeve, si dhe krahasimin në zhvillimin ekonomik të vendeve të BE-së, në kontekst të ndikimeve ekonomike në ekonominë e Kosovës në periudhën afatmesme.

Përveç pjesës tekstuale, projektligji përmban edhe pjesën tabelare me të dhëna për të hyrat dhe shpenzimet e përgjithshme sipas burimeve dhe strukturës së të hyrave për vitin 2016 dhe parashikimet për dy vjetët në vazhdim.

Ajo që duhet vlerësuar në këtë draft-buxhet është parashikimi për rritjen e të hyrave dhe shpenzimeve, duke u mbështetur në indikatorët e rritjes ekonomike. Në bazë të projeksioneve makroekonomike, gjatë vitit 2016 rritja ekonomike është paraparë të jetë rreth 4% në raport me bruto-produktin vjetor dhe kjo rritje pritet të mbështetet kryesisht në konsumin, dërgesat nga Diaspora dhe rritja e investimeve dhe zhvillimit të sektorit privat.

Ndërkaq, sfida për ekonominë e Kosovës vazhdon të mbetet bilanci tregtar negativ, i shoqëruar me një deficit të lartë tregtar, si rezultat i debalancës ndërmjet eksportit dhe importit dhe kjo është një brengosje në këtë drejtim, që është dominim i produkteve të konsumit në strukturën e importeve.

Përkundër shkurtimeve dhe kufizimeve që janë bërë në rishikimin e Buxhetit të vitit 2015, si rezultat i marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar, parashikimet për periudhën në vazhdim tregojnë për një buxhet stabil dhe i harmonizuar me rregullën fiskale prej 2%, që arrin t'i financojë shpenzimet aktuale dhe njëkohësisht ndarjen e mjeteve shtesë për ta mbuluar koston e mbështetjes së asistencës sociale prej 25%, implementimin e Ligjit për veteranët e luftës dhe Ligjit për skemat pensionale, të financuara nga shteti.

Gjithashtu, është për t'u vlerësuar edhe fakti se ky buxhet merr parasysh zbatimin e pakos fiskale, apo ndryshimeve të politikës fiskale, që kanë ndodhur gjatë këtij viti, fillimin e zbatimit të Marrëveshjes për Tregti të Lirë me Bashkimin Evropian apo Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Ajo që ndoshta mund të konsiderohet edhe ndryshim thelbësor në procesin e financimit në vitin e ardhshëm dhe në periudhat afatmesme, i parashikuar me këtë buxhet, është krijimi i mundësive për financimin e projekteve kapitale strategjike zhvillimore nëpërmjet huazimeve nga institucionet financiare ndërkombëtare pa e cenuar buxhetin e ndarë për projektet kapitale aktuale. Kjo do të bëhet e mundur si rezultat i marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, pasuar me ndryshimet që do të bëhen në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ku është paraparë mundësia që për një periudhë dhjetëvjeçare shuma maksimale e lejuar e financimit nga donatorët për projekte kapitale strategjike të mos jetë e kufizuar në nivelin e kufirit të deficitit aktual, por që huazimet nuk mund ta tejkalojnë normën prej 30% të bruto-produktit vendor.

Të nderuar deputetë,

Kam informacione që grupet parlamentare e kanë shqyrtuar buxhetin, e kanë diskutuar, po ashtu edhe komisioni ka punuar në këtë kohë deri te thirrja e kësaj seance. Kam për obligim të ju informoj që komisioni për herë të parë ka filluar ta përdorë metodën e raportimit, ndërsa secilit ministër ia kemi dërguar një shkresë, kemi treguar cili deputet i komisionit është i ngarkuar për sektorin e veçantë dhe kemi kërkuar nga ministrat që të caktohet një person përgjegjës të kontaktit dhe deputeti gjatë tërë vitit, është fjala për deputetin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, do të monitorojë dhe do të bashkëpunojë me atë institucion për ta përcjellë implementimin e buxhetit të atij sektori gjatë tërë vitit. Kështu që të jetë vetëm koha e raporteve

buxhetore, por thjesht ai institucion do të përcillet gjatë tërë vitit për implementimin e buxhetit të tij.

Dhe, konsideroj që komisioni do të fillojë të punojë tash në mënyrë intensive. Ne presim edhe bashkëpunimin me komisione. Shpresoj që nuk do të ndodhë më në leximin e dytë ajo që ka ndodhur në buxhetin e kaluar, kur amendamentet janë bërë të pakompletuara dhe janë votuar, por shpresoj në një kooperim më të madh me komisionin dhe ne do ta bëjmë krejt që është e mundur që ta kemi në finale një buxhet të mirë dhe të kënaqshëm për të gjithë.

Unë në emër të komisionit dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së ju ftoj që ta votoni buxhetin në lexim të parë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti kryetar! Tani, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, urdhëroni zonja Labinotë Demi!

LABINOTË DEMI: Faleminderit për fjalën, kryetar!

I nderuar kryeministër,
Zëvendëskryeministra,
Ministra,
Kolegë deputetë,

Si anëtare e Komisionit për Buxhet dhe Financa, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së i japim mbështetje projektbuxhetit në lexim të parë për vitin 2016. I ftojmë të gjithë deputetët që ta votojnë, në mënyrë që t'u hapim rrugë amendamenteve, për të cilat besoj se të gjithë së bashku jemi duke punuar dhe kemi kohë të mjaftueshme deri në datën e fundit, përkatësisht më 9 dhjetor, që të bëjmë një buxhet, i cili kënaq interesat e qytetarëve, pa dallim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Demi! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës e patëm qëndrimin e kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” nuk është këtu. Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk është këtu.

Grupi Parlamentar Lista serbe, urdhëroni zoti Slavko!

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

Poštovani predsedniče Vlade,
Poštovani potpredsednici Vlade,
Poštovani ministri,
Dame i gospodo narodni poslanici,
Poštovani ambasadore Sjedinjenih Američkih Država,
Poštovani šefe Kancelarije Evropske unije,
Predstavnici OEPS-a,

Poslanička grupa Srpske liste u načelu podržava Nacrt zakona o Budžetu Kosova za narednu 2016. Godinu, i mi ćemo svoj doprinos dati kroz stalne i funkcionalne komisije, u kojima su poslanici Srpske liste zastupljeni, i očekujem da naši amandmani koje budemo podneli u Budžet, odnosno kroz Komisiju za budžet i finansije budu inkorporirani u ovaj nacrt zakona, kako bi na drugo čitanje imali konsenzus i zajedno dali podršku ovom nacrtu zakona. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar! Grupi Parlamentar “Nisma” nuk është këtu. Nga Grupi Parlamentar “6+”, zoti Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar “6+” këtë herë do të abstenojë për Buxhetin e viti 2016 për shkak të pakënaqësisë me ndarjen e mjeteve për komunitete.

Ju e dini që më 2015 ne e kemi paraqitur një amendament. Nuk e kemi kërkuar asnjë cent shtesë buxhet, por kemi kërkuar që të ndahet buxhet për secilin komunitet. Ju deputetë e keni votuar, unë ju falënderoj për Buxhetin e vitit 2015 që i keni mbështetur këto amendamente. Unë besoj se edhe në Buxhetin e vitit 2016 do ta paraqesim prapë një amendament kësi lloj, por ne kemi kërkuar dhe kemi pritur prej ministrit që do të vijë një ndarje, që ne të mos paraqesim një amendament, por nuk erdhi. Ashtu që ne do të abstenojmë. Ne kemi kërkuar që të ndahen dy kode. Një kod ka qenë brenda Kryeministrit, buxheti është 1,2 milion euro, por kemi mësuar që prej atij buxheti 800 mijë euro ka shkuar në suficit, vetëm 400 mijë euro janë harxhuar për komunitete. Jo që nuk kemi pasur projekte, por nuk janë aprovuar prej anës së Zyrës së Kryeministrit.

Kështu që në komision gjatë leximit të dytë do ta paraqesim prapë një amendament, me të cilin do të kërkojmë ndarjen e kodit në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar Damka! Tani është radha e paraqitjes për deputetë, me ngritje dore, ju lutem! Profesori Muhamet Mustafa, pastaj bëhet gati Zenun Pajaziti, Emilija, e pastaj Vjosa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ambasadorë,

Unë shkurtimisht do t’i them disa gjëra, të cilat mendoj se është me rëndësi të konstatohen.

Së pari, ne po hyjmë në një vit të ri buxhetor me disa rezultate të mira, siç është rritja e të ardhurave buxhetore përtej parashikimeve dhe me një tendencë më të madhe kursimi. Mendoj se këto janë dy ndryshimet më cilësore edhe në krijimin e buxhetit, edhe në menaxhimin e buxhetit.

Ajo që sivjet më duket mua së është mirë ka të bëjë me një trend të rritjes së të ardhurave, e para.

E dyta, e kemi një diversifikim të burimeve të financimit për projekte të infrastrukturës, të cilat deri më tani janë financuar kryesisht apo krejtësisht nga buxheti dhe tash kemi më tepër burime, gjë që do ta lirojë buxhetin nga barra e rëndë dhe një pjesë e mjeteve në vitet e ardhshme të orientohen më shumë në arsim, shëndetësi dhe nevoja tjera.

E treta, e kemi një konsistencë më të mirë të treguesit makroekonomikë, ndonëse unë ende nuk jam i kënaqur me nivelin e analizës makroekonomike. Mungojnë disa tregues qenësorë lidhur me konfiguracionin makroekonomik, siç është treguesi i punësimit, gjë që është një tregues kyç, dhe treguesi që ka të bëjë me strukturën e prodhimit, përkatësisht të industrisë. Këto janë dy çështje kyçe të politikave ekonomike dhe unë e lus edhe ministrin e Financave, por edhe kryetarin e Kuvendit dhe të gjithë këta që ne të bëjmë çmos që në Ministrinë e Financave të forcohet edhe më tepër Njësia për Analiza Makroekonomike dhe në Agjencinë e Statistikave të Kosovës të dedikojmë më shumë mjete dhe të kemi statistika të mira, sepse pa statistika të mira lidhur me punësimin, lidhur me prodhimin, ne nuk do të mund ta tejkalojmë, nuk mund ta rritim eksportin, nuk mund ta zvogëlojmë papunësinë, e këto janë problemet kryesore për Kosovën.

Mendoj se të gjithë e dimë, edhe ministri është një makroekonomist i shkolluar, prandaj unë kërkoj prej tij që me të vërtetë ta bëjë një ekip të fortë në Njësinë e Analizave Makroekonomike dhe ta zgjedhë statusin e tyre. Unë jam informuar kështu kalimthi që ka pak probleme me statusin e tyre, eë që mund ta kuptoj që janë vështirësitë buxhetore, por ai është vendi i fundit ku duhet ne të bëjmë shtrëngesa buxhetore në këmbim të një analize jo sa duhet komplete makroekonomike.

Gjithashtu, mendoj se duhet ta shohim në statistikë Njësinë për Statistikat Kombëtare dhe bilancet kombëtare për GDP-në, për prodhimin industrial duhet ta kemi gjithmonë. Atje duhet të investojmë më shumë mjete dhe më shumë kuadro.

Dy-tri probleme që nuk i kemi analizuar dhe ndoshta me buxhet është vështirë të adresohen janë të ardhurat e imobilizuara nga Fondi i Privatizimit dhe nga disa sektorë. Mendoj se në kohën kur ne duhet të gjenerojmë vende të punës duhet të krijojmë parakushte dhe duhet të nxjerrim ligje, që t'i mobilizojmë ato mjete për investime për gjenerim të vendeve të punës, sepse ministri tha që Kosova i ka 27% të investimeve publike dhe private bashkë me GDP-në, por niveli i zhvillimit të Kosovës dhe problemi i papunësisë së Kosovës nuk do të duhej të kishte më pak se 30-32% të investimeve në GDP. Prandaj, ne duhet ta gjejmë këtë zgjidhje këtu lidhur me këtë.

Çështja tjetër ka të bëjë me huat. Unë e përsëris, se e përsërideta edhe diversifikimin e burimeve, por mendoj se Kuvendi, por edhe Qeveria, duhet ta nxjerrim një vendim shumë të prerë. Asnjë hyrje hua në kredi pa studim fizibiliteti për projekte të caktuara, sepse edhe 15% e GDP-së, në qoftë se shkon në projekte që kanë kthim të ulët të investimeve, do të jetë barrë e rëndë për Kosovën. Prandaj, të mos mashtrohemi ne vetëm me 30%-shin e GDP-së që e kemi të lejuar, por t'i përgatitim studimet e fizibilitetit dhe projektet mirë, në mënyrë që, unë i përsëris të gjitha këto, janë të mira, hekurudhat, infrastruktura, të gjitha këto janë në rregull, por prioritetet caktohen me studimin e fizibilitetit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti profesor! Ju kisha lutur, meqë e kemi për vizitë mbretin e Jordanisë, të gjithë do ta marrin fjalën, por të jenë vetëm kërkesa. Zenun Pajaziti, Emilija le të bëhet gati, Vjosa, dhe s'ka më të lajmëruar. Pra, kush e kërkon fjalën pastaj do t'ia jap, por përparësi kanë kryetarët e grupeve parlamentare për shkak të vizitës së mbretit të Jordanisë. Urdhëroni!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ambasadorë,

Kolegë deputetë,

Pa dyshim që në këto kushte nuk është mënyra më e mirë dhe e këndshme për të bërë debate të gjata, qoftë edhe për buxhetin.

Do të mundohem t'i adresoj dy çështje që më takojnë më shumë si deputet.

E para, është çështja e financimit të Radiotelevizionit Publik të Kosovës. Më erdhi mirë që ministri i Financave e theksoi se pas atij formati të buxhetit e kanë lansuar një buxhet për një periudhë të vitit dhe mendoj që kjo është mirë. Mendoj po ashtu se do të kishte qenë më mirë që kjo të kishte figuruar qysh më herët dhe të mos ishte bërë një debat ndoshta i panevojshëm për punën e Radiotelevizionit të Kosovës.

Dua të shtoj edhe diçka. Ne si deputetë kemi bërë disa debate këtë vit për Radiotelevizionin, por nuk e kemi kryer punën tonë, jo vetëm si deputetë, por edhe si parti politike, e si koalicion, për ta gjetur një zgjidhje të qëndrueshme për mënyrën e financimit të Radiotelevizionit Publik.

Ne e kemi nisur ndryshimin e ligjit dhe unë po ju bëj thirrje këtu për të pasur qëndrime politike për të adresuar dhe vendosur qysh ta financojmë Radiotelevizionin Publik, sepse 5-6 muaj shkojnë shpejt dhe ne prapë do të mbetemi pa një zgjidhje për këtë çështje.

Mendoj se mënyra më e mirë se si të ndikohet në atë institucion pozitivisht është për t'i zgjedhur njerëzit më të mirë në bordin e tij, dhe meqë edhe tash është një proces i zgjedhjes së anëtarëve të bordit, ju kisha lutur që mënyrën e përmirësimit të efikasitetit të punës të këtij institucioni ta bëjmë nëpërmjet zgjedhjes së njerëzve më të mirë aty.

Dhe një çështje tjetër, krejt shkurt! Po e shfrytëzoj praninë e kryeministrit, të zëvendëskryeministrit, të ministrit të Financave për një projekt të infrastrukturës.

Para më shumë se dy vjetësh, ish kryeministri Thaçi e ka lansuar një projekt për zgjerimin e rrugës Prishtinë-Gjilan-Konçul dhe mendoj se ka qenë koha që në këtë vit buxhetor të lansohet pjesa e parë për fillimin të paktën të zgjerimit të kësaj rruge.

E di që më pastaj ky projekt është ndryshuar dhe është bërë edhe një projekt tjetër për një rrugë krejtësisht të re, por mendoj se duhet të jepet një sqarim se ku është ky projekt dhe si është puna me të, kur do të lansohet buxheti, a ka ndonjë kredi, a do të fillohet së pari me zgjerimin e kësaj rruge, që nuk është vetëm për një qytet apo një regjion, por është edhe për Luginën e Preshevës dhe është kërkesë që mendoj do të duhej ta kemi edhe një studim se pse kjo rrugë po mbetet e fundit, ose pse disa rrugë tjera po bëhen para saj, para se të informohet publiku dhe qytetarët e asaj ane. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetë të nderuar,

Unë askujt s'do t'ia ndal fjalën, por po kam reagime, meqë do të jetë vizita e mbretit të Jordanisë, prandaj për këtë arsye urdhëroni flitni më shkurtër dhe thjesht. Emilija, Vjosa, e pastaj Gëzimi, Shpejtim Bulliqi dhe Shaipi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedniče!

Poštovani kolege poslanici,

S obzirom da danas održavamo sednicu pod jako teškim uslovima i okolnostima, ja ću u pismenoj formi dostaviti Parlamentarnoj grupi PDK-a prioritete projekte za Bošnjačku zajednicu, a odnose se na veću podršku Ministarstva za poljoprivredu u mestima gde žive Bošnjaci, a koja su pogodna za razvoj raznih poljoprivrednih grana, što do sada nije slučaj, jer su manjinske zajednice diskriminisane u samom startu da konkurišu zato što Ministarstvo za poljoprivredu ima kriterijume koje manjinske zajednice ne mogu da ispune.

Od Ministarstva za trgovinu zahtevam i ekonomski razvoj, da malo više projekata da manjinskim zajednicama, kako bi bili što bolje integrisani u kosovskom društvu.

Pošto je ministar za Infrastukturu, nama je jako bitno, poštovani ministre, da se fokusirate na podršku oko rekonstrukcije lokalnih puteva u mestima gde žive Bošnjaci, a odnose se na lokalna sela.

Ono što nama konkretno jeste veliki problem je Ministarstvo za ambijent i prostorno planiranje iz razloga zato što je narušen život meštana okolnih sela u regionu Župe, zato što je katastrofalno stanje na Prevalcu, odnosno vodovodna i kanalizaciona mreža koja je gore nepristupačna stanovništvu narušava bezbednost naših građana.

Naše smo projekte dostavili preko Skupštine opštine Prizren i oni su uvrstani u budžetu, a ono što je najbitnije za 2016. godinu je izgradnja nacionalnog projekta kakav je bošnjački kulturni centar u Prizrenu.

Podržaćemo ovaj budžet i glasaćamo za. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit, e nderuar deputete! Ka mbetur tash Vjosa, Gëzimi, Shpejtimi e Shaipi. Dhe, më falni, por paraprakisht të them se e kemi harruar njërin nga momentet më të veçanta, sepse kemi pak edhe përgjegjësinë njerëzore.

Opozita është duke ia nxjerrë fundin me sjelljen e vet, edhe në mënyrën institucionale, por edhe për këtë gabim, për shkak të emergjencës.

Pra tani, ju kisha lutur që ta mbajmë një minutë heshtje për viktimat e terrorizmit në Paris!

(Një minutë heshtje)

Nderime! Vjosa, urdhëro, e ke fjalën!

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Po provoj të flas shumë shkurt! Në fakt, në mënyrë që të mos bëjmë amendamente të panevojshme, do të kërkoj një sqarim nga ministri i Punës, i cili tashmë paska shkuar, por ndoshta ministri i Financave në vend të tij mund të sqarojë.

Është fjala për pensionet bazë kontributdhënëse për të cilat ministri i Financave tha se është siguruar fondi që të paguhet përvoja e punës.

Siç e dini, në buxhetin e vitit të kaluar është bërë një amendament lidhur me njohjen e përvojës së punës për vitet 1989-1999 për sektorë të caktuar. Pra, po flasim për sistemin e vendosur atëbotë të Republikës së Kosovës, të themeluar nga presidenti Rugova, gjatë të cilit kanë punuar edhe arsimtarë, edhe punëtorë tjerë të arsimit, të shëndetësisë e të tjerë.

Siç e dini, ka qenë një pajtueshmëri e këtij Kuvendi që të njihet ajo përvojë e punës. Megjithatë, në praktikë nuk është zbatuar te shumë njerëz dhe lidhur me këtë materialet unë do t'ia dorëzoj drejtpërdrejt edhe ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, sepse me gjithë faktit që ka qenë pjesë e buxhetit, ajo përvojë nuk i është njohur një numri të madh. Unë shpresoj të ketë qenë gabim teknik apo diçka tjetër.

Megjithatë, për buxhetin e këtij viti përsëri thuhet vetëm pensionet bazë kontributdhënëse, e pastaj është një asteriks, mirëpo poshtë nuk sqarohet çka saktësisht nënkupton ai asteriks, kështu që shpresoj se ndonjëri nga ministrat mund të përgjigjet, në qoftë se kjo nënkupton edhe kontributdhënësit, pra me njohjen e përvojës së punës gjatë viteve 1989-1999. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Gëzim, fjala është për ju! Le të bëhet gati Shpejtimi, e pastaj edhe Shaipi!

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuar ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës,

I nderuar përfaqësues i Zyrës së BE-së, ambasador i BE-së,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues të mediave,

Rrethanat e tilla dhe pamundësia që të hyj në detaje, bëjnë që edhe unë nuk do ta zgjas shumë në fjalim.

Vërejtja ime ka të bëjë kryesisht me përvojën e legjislativave të kaluara. Fatkeqësisht, nuk po dua të paragjykoj se do të ndodhë e njëjta gjë edhe në këtë mandat dhe në këtë legjislaturë nga disa anëtarë të Komisionit për Buxhet dhe Financave, por fatkeqësisht ne shumica që kemi qenë edhe në mandatin e kaluar e dimë se disa deputetë të këtij komisioni kanë proceduar amendamente në këtë komision, të cilat ndërliken me projektet në vendet, regjionet apo nga komunat dhe qytetet nga vinë ata, dhe ju e dini se një gjë e tillë ka ndodhur për faktin se atyre u dashur që në zgjedhjet e ardhshme ta kenë mbështetjen e asaj komune apo të atij rajoni.

Nuk po dua mendoj se do të ndodhë prapë e njëjta gjë, por e kam një këshillë për anëtarët e këtij komisioni: Ju lutem, mos procedoni amendamente që lidhen me interesat tuaja lokale! Ky buxhet

është i Kosovës në tërësi. Kosova ka shumë nevojë, e veçanërisht shëndetësia kosovare për mbështetje shumë më madhore se tash. Kanë nevojë shumë shtresa të veçanta të popullit, siç janë: kategoria e shurdhmemecëve e shumë familjeve që janë larguar nga skema sociale, prandaj t'i kemi parasysh të gjitha këto kategori dhe mos procedoni amendamente që lidhen me interesat tuaja lokale sikur që ka ndodhur në të kaluarën me projekte kulturore, projekte të rrugëve dhe projekte sportive. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Gëzim! Shpejtim? Zonja Salihaj, tjetër herë! Shaip? Tjetër herë! Faleminderit... Atëherë, urdhëro Shaip!

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Mendoj se menaxhimi i buxhetit në këtë mënyrë do të gjenerojë shumë mangësi dhe shumë pyetje të cilat do të reflektojnë edhe në zhvillimin ekonomik dhe në cilësinë e funksionimit të shumë institucioneve.

Meqë nuk kemi kohë, unë propozoj që ministrat e çdo dikasteri në këtë sallë, për ata që janë të interesuar, të krijojnë seanca me deputetë, të cilët do të marrin pjesë për pyetje e përgjigje.

Unë kam propozime për ministri të caktuara, e në këtë rast për Ministrinë e Shëndetësisë, e cila me këtë planifikim paraqet shumë dobësi, të cilat për t'i krijuar kushtet nuk do ta funksionalizojë sistemin, por do ta defunksionalizojë dhe në mënyrën tjetër është duke u krijuar përshtypja se këtu bëhet vetëm një menaxhim që me interpretimin gjuhësor menaxherial, këta quhen vetëm menaxherë të krizave të tullave. Dinë vetëm të ndërtojnë objekte, por jo funksionalizim.

Mandej, ka edhe shumë probleme tjera, duke filluar se nuk përcaktohet në rritjen e pagave të punonjësve shëndetësorë, të cilët janë strukturë specifike e Republikës së Kosovës, nuk garanton rritjen e punonjësve shëndetësorë në sistemin shëndetësor, duke u bazuar në evidencë, duke u bazuar në nevoja, por po ashtu në investime për teknologjinë shëndetësore, e cila sot paraqitet vetëm me numra, e jo me specifikim se kush është ajo teknologji. Dhe, nuk analizon që në tregun e shërbimit shëndetësor sot ka 75 milionë informalë brenda Kosovës, sipas studimeve të Bankës të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, dhe 120 milionë dalin jashtë shtetit për shërbime nga qytetarët e Republikës së Kosovës. Në total, me këtë buxhet që është ndarë arrin në 350-400 milionë, ndërsa përfundimisht sistemi i informimit shëndetësor, po e përsëris, dhe e kam përsëritur disa herë, se nuk do të funksionojë dhe është e turpshme, arrin vlerën nga viti 2002 deri sot mbi 30 milionë euro, në një Republikë me 2 milionë banorë, me 8 spitale regjionale dhe me këtë shërbim kaq të vogël shëndetësor të mos funksionojë kjo vlerë kaq e madhe paraqet shumë pikëpyetje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet! A ka ndokush tjetër të paraqitur? Po e shoh që nuk ka. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën.

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Nëse ka ndonjë deputet duke ardhur, le të vijë sa më shpejt, përndryshe 76 deputetë jemi brenda në sallë.

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për miratimin në parim të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Kush është kundër? 1 është kundër!

Kush abstenon? 6 abstenojnë.

Në ndërkohë erdhën edhe tre deputetë.

Kush është për?

Prapë, erdhën edhe tre deputetë, ta keni parasysh!

Ju lutem, sa janë të pranishëm në sallë? Janë 79.

Atëherë, 71 janë për, 7 kanë abstenuar dhe 1 është kundër.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me vendim të seancës plenare, të mbajtur më 17 nëntor 2015, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raporte me rekomandime.

E ftojme opozitën që të marrë pjesë në punimet e seancave plenare.

Me këtë, i mbyll punimet e seancës së sotme plenare. Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*